



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 449/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga, Z.Agton Ramadani- Kryetar, Znj. Kimete Gashi- Anëtare Z. Vedat Potërqi- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE "AS TECH" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale" me Nr të Prokurimit: 616-22-1994-1-2-1, iniciuar nga AK-Komuna Prishtinës, me datën 12.12.2022 mori këtë:

VENDIM

I. Aprovohet si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE "AS TECH" SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale" me Nr të Prokurimit: 616-22-1994-1-2-1, iniciuar nga AK-Komuna Prishtinës, lidhur me mos zbatimin e vendimit nr.201/22, ndërsa **Anulohet në tërësi**, ky aktivitet i prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

II. Shqiptohet gjoba në të holla për Autoritetin Kontraktues në lartësi të shumë 5.000,00 €, për shkak të mosrespektimit të Vendimit të OSHP Psh nr.201/22 të datës 05.08.2022, në pajtim me nenin 131, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;

III. Urdhërohet Autoriteti Kontraktues- Komuna e Prishtinës, që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së: PSh. nr. 201/22 dhe 449/22, të datës 05.08.2022 dhe 12.12.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale" me Nr të Prokurimit: 616-22-1994-1-2-1.

IV. Mos respektimi i kësaj urdhërese në afat prej pesë ditësh kalendarike do ta detyrojë Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe në të njëjtën kohë të kërkojë nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK-së /Komuna e Prishtinës, konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

V. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me 14.03.2022, Autoriteti Kontraktues –Komuna e Prishtinës ka publikuar Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale” me Nr. të Prokurimit: 616-22-1994-1-2-1.

AK me datë 24.05.2022 ka publikuar vendimin e AK për këtë procedurë duke e propozuar për kontratë OE “Sabri Azemi B.P”.

Me datë: 29.05.2022 OE ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të AK.

Me datë: 02.06.2022 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe është dorëzuar ankesa në OSHP.

Me datë: 05.08.2022 OSHP e kthen lëndën në RIVLERËSIM dhe konstaton si të bazuara shkeljet e pretenduara dhe citon se OE “Sabri Azemi “ BI është i papërgjegjshëm.

AK me datë: 22.08.2022, përsëri në kundërshtim me Vendimin e OSHP **nr.201/22 të datës 05.08.2022** ka shpërblyer me kontratë të njëjtin OE i cili në bazë të vendimit të lartcekur ky OE ka rezultuar të jetë i pa përgjegjshëm.

Operatori ekonomik ankues: “AS TECH” Sh.P.K, si palë e pakënaqur, ka parashtruar ankesë në OSHP me date 08.09.2022 me nr.449/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale” me Nr. të Prokurimit: 616-22-1994-1-2-1, duke pretenduar se:

Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar vendimin e PSH. Nr. 201/22 të datës 05.08.2022, si dhe ka eliminuar padrejtësisht OE ankues.

Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59, dhe nenin 7 të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, dhe nuk ka respektuar dispozitat tjera ligjore lidhur më këtë procedure.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 12.09.2022 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e datës 07.10.2022, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues: “AS TECH” SH.P.K, në përfundimin e analizës dhe rishikimit të këtij aktiviteti të prokurimit,

konstaton si në vijim:

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues "AS TECH" Sh.P.K, eksperti shqyrtues, sqaron se pretendimet e bëra në ankesë janë të njëjta me pretendimet ankimore të lëndës paraprahe, të cilave u përgjigj Paneli Shqyrtues në vendimin e datës 05.08.2022. Psh. nr.201/22.

Andaj eksperti shqyrtues sqaron se ankesa e OE ankues përsëritet për herë të dytë dhe se ankesa pretendon konform Rregullores së Punës së OSHP-së konkretisht neni 16.2 të trajtohet si "Res Judicata".

Po ashtu neni 105 paragrafi 2.16 i LPP-së sqaron: "Në rastet e përsëritura me të njëjtat pretendime ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, në rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i Panelit Shqyrtues i trajton si çështje të gjykuara "res judicata".

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, si: Ankesat e OE ankues, raportet e ekspertit shqyrtues, vendimin nr.201/22, PSH konstaton se, duke pasur parasysh se vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim, këtë vendim AK në këtë rast nuk e ka zbatuar, kështu duke rekomanduar OE të klasifikuar si të papërgjegjshëm sipas vendimit nr.201/22 përsëri, PSH konstaton se sa i përket kësaj çështje kjo ka qenë çështje e gjykuar, andaj lidhur me këtë pretendim aplikohet neni 105 i LPP-së, përkatësisht par.2.16 i cili saktëson se: "Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata"."

PSH, përmes këtij vendimi, urdhëron Autoritetin Kontraktues (AK) - Komunën e Prishtinës që të ndër marr masa për zbatimin e vendimit të lartpërmendur në afat prej pesë (5) ditësh, mos respektimi i këtij urdhri, në afat prej pesë ditësh kalendarike, do ta detyrojë panelin shqyrtues që të respektoj nenin 131 të LPP-së dhe njëkohësisht të kërkojë nga KRPP-ja që t'i anulojë licencën menaxherit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) - Komuna e Prishtinës në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Lidhur me eliminim e OE ankues mbi arsyen se OE ankues nuk ka vazhduar sigurimin e tenderit si dhe pretendimet e OE ankues lidhur me këtë çështje, PSH konstaton se janë pretendime të pagjykuara me vendimin 201/22 si dhe këto rrethana janë të ngritura pas vendimit në fjalë, andaj PSH konstaton se do të hedhet në shqyrtimin e këtyre pretendimeve dhe në këtë rast nuk mbështet raportin e ekspertizës që lënda të trajtohet res-judicata në tërësi.

Lidhur me këtë çështje, konform RROUPP, neni 31.4 saktëson se Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit, gjë që AK në këtë rast ka ndërmarrë veprimin konform kësaj pike, ku ka kërkuar nga OE ankues zgjatjen e validitetit para skadimit të tij, mirëpo OE ankues ka bërë vazhdimin e me datë 11.08.2022, ndërsa i njëjti ka skaduar me datë 18.07.2022, kjo bie në kundërshtim me dispozitat në fuqi, me të cilat saktësohet se vazhdimi i sigurimit duhet të bëhet nga data e skadimit të tij konform kërkesës së AK, e që në rastin konkret nuk është bërë, andaj rrjedhimisht lidhur me këtë pike, AK ka eliminuar OE ankues konform LPP-së, prandaj këto pretendime të OE ankues, PSH i klasifikon si të pa-bazuara, si dhe duke qenë se OE tjetër pjesëmarrës në këtë aktivitet (Termovent shpk) nuk ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim apo eventualisht ankesë lidhur me eliminimin e tij në faza të mëhershme, PSH e klasifikon si palë pa interes në këtë aktivitet meqë janë shtjerrur edhe afatet kohore për dorëzimin e po të njëjtave.

Duke pasur parasysh faktet, rrethanat, veprimet si dhe se çka u tha si më sipër, PSH konstaton se tanimë të gjitha ofertat rrjedhimisht janë të papërgjegjshme andaj në mungesë të tyre vendos që këtë aktivitet prokurimi ta anulojë në tërësi, konform dispozitave të LPP-së.

Paneli Shqyrtues konform nenit 117 dhe nenit 105 paragrafi 2.10 të LPP-së, dhe në bazë të dëshmimeve të paraqitura më lartë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna e Prishtinës;
- 1x1 OE- “AS TECH” SH.P.K;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.